

VENDIM
Nr. 325, datë 18.5.2022

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (në vijim “DPM”) si person juridik publik buxhetor, i specializuar për metrologjinë, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë (në vijim “ministri”), me seli në Tiranë.

2. DPM-ja financohet nga buxheti i shtetit. Buxheti i DPM-së është pjesë e buxhetit të ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

3. DPM-ja, si institucioni kombëtar shtetëror për metrologjinë në Republikën e Shqipërisë, ka si mision të sigurojë rregullimin e sistemit kombëtar të metrologjisë në Shqipëri dhe të kërkesave për të kryer veprimtaritë në metrologjinë shkencore, industriale dhe atë ligjore.

4. DPM-ja e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në këto fusha përgjegjësie:

- a) Sistemin e njësisë së matjes;
- b) Sigurimin e gjurmueshmërisë së matjes nëpërmjet standardeve të matjes;
- c) Kontrollin metrologjik ligjor të instrumenteve matëse, parapaketimeve dhe shisheve;
- ç) Autorizimin e monitorimin e personave juridikë dhe fizikë për të kryer veprimtari në metrologjinë ligjore.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË

DPM-ja ka përgjegjësi të organizojë punën për të siguruar:

- a) përdorimin e njësive matëse në përputhje me Sistemin Ndërkombëtar të Njësive;
- b) gjurmueshmërinë e standardeve të matjes të Republikës së Shqipërisë ndaj standardeve ndërkombëtare dhe standardeve kombëtare të vendeve të tjera;
- c) ngritjen dhe administrimin e laboratorëve të ruajtjes së etaloneve kombëtare të matjeve, si dhe ato të kalibrimit e të verifikimit të instrumenteve matëse, në përputhje me standardet kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare, për metrologjinë dhe kërkesat ligjore në fuqi;
- ç) kompetencën teknike të laboratorëve të etaloneve kombëtare të matjeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë nëpërmjet vetëdeklarimit të kapaciteteve matëse dhe kalibruese, sipas marrëveshjes së njohjes së ndërsjellë të Komitetit Ndërkombëtar të Peshave dhe Masave ose akreditimit;
- d) kompetencën teknike të laboratorëve kalibrues dhe verifikues të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë nëpërmjet akreditimit, në përputhje me standardet kombëtare, evropiane e ndërkombëtare dhe praktikat e njohura në nivel evropian e ndërkombëtar;
- dh) lëvizjen e lirë të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, të cilat janë objekt i markimit CE, dhe markimin metrologjik;
- e) lëvizjen e lirë të produkteve të parapaketuara, nëse ato kanë shenjë e konformitetit dhe harmonizimin e metodave për matjet e kontrollin metrologjik;

ë) matje uniforme në Republikën e Shqipërisë dhe besim në rezultatet e matjeve të kryera në funksion të tregut;

f) mbrojtjen e konsumatorëve dhe të shtetit nga rezultatet e pasakta të matjeve të instrumenteve matëse.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË

1. DPM-ja e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në:

a) nivel qendror, nëpërmjet drejtorisë qendrore;

b) nivel rajonal, nëpërmjet sektorëve të shërbimit, me vendndodhje sipas përcaktimit në urdhrin përkatës të miratimit të strukturës dhe organikës së DPM-së.

2. Struktura organike e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

3. DPM-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon veprimtarinë saj dhe përgjigjet përpara ministrit.

4. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm të DPM-së dhe nëpunësve të saj rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë të DPM-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

5. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjellja e personelit të DPM-së miratohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm.

6. DPM-ja, përveç detyrave të përcaktuara në ligjin për metrologjinë, kryen edhe këto detyra:

a) Harton dhe dërgon për miratim, pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë, planin afatgjatë për zhvillimin e etaloneve kombëtare të matjeve, bazuar në nevojat e vendit, çdo 4 (katër) vjet;

b) Harton dhe dërgon për miratim nga ministri planin vjetor të veprimtarisë së DPM-së;

c) Nëpërmjet drejtorit të përgjithshëm, raporton te ministri periodikisht dhe sa herë që kërkohet prej tij;

ç) Çdo detyrë tjetër brenda fushës së tij të përgjegjësisë, të ngarkuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për metrologjinë, si dhe nga ministri.

7. DPM-ja ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema e DPM-së ka shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria (emri i ministrisë përgjegjëse), Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë”, në përputhje me përcaktimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

8. Vula e DPM-së ka elementet dhe formën e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, të kontrollit dhe të ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 1576, datë 17.10.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama